

KONCESIONE / PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës	Dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kalivaç”
Forma e kontratës	B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)
Burimi i financimit	Shoqëri tregtare private / Kapital privat
Vlera e parashikuar e projektit:	125,287,800 Euro (pa TVSH)
Kohëzgjatja e kontratës :	35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 21 datë 29.5.2017

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me ofertën përkatëse të ofruar si më poshtë:

- Shoqëria “Doko” sh.p.k. – Skualifikohet pasi ka dorëzuar vetëm Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); Certificate Regjistrimi i personit të Tatuashëm (NUIS); Vërtetim nga Zyra Përmbartimore Elbasan; Vërtetim nga Drejtoria Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj; Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan; Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj Tiranë, për xhiron vjetore; Certificate të Sistemit të Menaxhimit lëshuar nga Euro Cert; Formular Vlerësimi për punime të ngjashme; Licenca Profesionale NZ. 1153/17 si dhe Kontratë pune, CV, Diplomë, Licencë e inxhinierit mekanik, dhe nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion tjetër të kërkuar nga shtojca nr. 9 e Dokumentave të Koncesionit.
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Favina” sh.p.k. dhe “Gener 2” sh.p.k. – Kualifikohet në vend të 2 (dytë) me 35.33 pikë, me këto karakteristika kryesore të ofertës:
 - Vlera e “Fee koncesionare” 2 % (2,456,000 kWh)
(e shprehur në % të energjisë elektrike vjetore të prodhuar)
 - Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 122,800,800 kWh
 - Ndikimi ekologjik dhe social Referencë Studimi

- Fuqia e instaluar e përcaktuar me prurjen llogaritëse 40,000 kW
 - Koha e zbatimit të punimeve 72 muaj
3. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Ayen Enerji” A.Ş. dhe “Fusha” sh.p.k. – Kualifikohet në vend të 1 (parë) me 95 pikë, me këto karakteristika kryesore të ofertës:
- Vlera e “Fee koncesionare” 2.1% (7,699,080 kWh)
(e shprehur ne % te energjisë elektrike vjetore te prodhuar)
 - Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 366,622,856 kWh
 - Ndikimi ekologjik dhe social Referencë Studimi
 - Fuqia e instaluar e përcaktuar me prurjen llogaritëse 111,000 kW
 - Koha e zbatimit të punimeve 30 muaj

* * *

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron **Z. Yigit Arman**, Përfaqësues me Prokurë, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Ayen Enerji” A.Ş. dhe “Fusha” sh.p.k., me adresë: Blloku i Vilave “Rolling Hills”, Vila nr. 79, Lundër, Tiranë, se oferta e paraqitur më datë 28 Gusht 2017, për marrjen me koncesion të hidrocentralit “Kalivaç”, është pranuar.

Afati i negociimit të Kontratës Tuaj do të jetë brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit të fituesit.

Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive “Ayen Enerji” A.Ş. dhe “Fusha” sh.p.k., kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentet e mëposhtme:



- Kopjen e vënies në dijoni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat Standarde të Procedurës Konkurruese, në vlerën e 10% të Investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Krijimin e Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit “Shoqëri koncesionare” dhe me objekt “Objektin e kontratës së koncesionit”, me të cilin Autoriteti Kontraktues do të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit, me personin e autorizuar të shoqërisë në fjalë.
- Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajnë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike. Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.
- Dokument bankar që vërteton pagesën e kryer për shpenzimet e publikimit të Njoftimit të Kontratës në Revistën “The Economist” në vlerën 977,650 lekë.
Referencat bankare lidhur me këtë pagesë janë:

RAIFFEISEN BANK

Kodi i Institucionit 1093001 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kodi I Degës Thesarit 3535

Llogaria “ Depozita te Qeverise “ në lekë AL 121011100800000002111008 L

Kjo pagese do të kryhet para fillimit të negociatave

- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.10.2017

Ankesa: Nuk ka